

Samiti i Diasporës Shqiptare
“Përmes rrënjëve lartësohemi”



SAMITI **IV**
DIASPORËS

AGJENDA

13 — 15 Prill 2026
Tiranë, Shqipëri

E HËNË - 13 PRILL

TEATRI I OPERAS DHE BALETIT

18⁰⁰

CEREMONIA E MIRËSEARDHJES

Hapja e Samitit IV të Diasporës Shqiptare

Dekorimi i Personaliteteve të Diasporës nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë

E MARTË - 14 PRILL

PALLATI I KONGRESEVE - SALLA E KONCERTEVE

09⁰⁰ - 09³⁰ **REGJISTRIMI**

09³⁰ - 10³⁰ **HAPJA E PUNIMEVE**

Shfaqje video - histori suksesi

Fjala e hapjes: SH.T.Z. Ferit HOXHA - Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme

Folës Kryesor: SH.T.Z. Edi RAMA - Kryeministër i Republikës së Shqipërisë

PALLATI I KONGRESEVE - HOLLI KRYESOR

10³⁰ - 12³⁰

PANELI 1

DIASPORA DHE DEMOKRACIA PËRFAQËSUESE NË HAPËSIRËN SHQIPTARE: NGA VOTA TE PËRFAQËSIMI INSTITUCIONAL

Nën kujdesin e Kuvendit të Shqipërisë, paneli do të trajtojë rolin gjithnjë në rritje të diasporës shqiptare në proceset demokratike dhe politike të vendin e origjinës. Ai fokusohet në sfidat dhe mundësitë që lidhen me përfshirjen e qytetarëve jashtë territorit në zgjedhje, duke analizuar mekanizmat e votimit nga jashtë si dhe nevojën për të kaluar nga një pjesëmarrje simbolike përmes votës drejt një përfaqësimi më të strukturuar dhe institucional të përfaqësimit politik të diasporës. Përmes diskutimeve dhe perspektivave të ndryshme, do të synohet të nxitet një debat më i gjerë mbi mënyrën se si diaspora mund të kontribuojë në forcimin e demokracisë, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e qeverisjes në hapësirën shqiptare.

Moderator: Z. Flori Gjini - Gazetar

Folës Kryesor: SH.T.Z. Niko Peleshi - Kryetar i Kuvendit Republikës së Shqipërisë

Panelistë:

- **SH.T.Z. Afrim Gashi** - Kryetar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut
- **Z. Nik Gjeloshaj** - Zëvendëskryeministër për Politikën Ekonomike dhe Ministër i Zhvillimit Ekonomik të Malit të Zi
- **Z. Taulant Balla** - Deputet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë
- **Z. Enkel Rexhepi** - Kryetar i Këshillit Kombëtar Shqiptar - KKSH, Lugina e Preshevës

Diskutim - P&P

PALLATI I KONGRESEVE - SALLA E ALBANOLOGJISË

11⁰⁰ - 13⁰⁰

PANELI 2

DIASPORA PARTNER NË BIZNES DHE INOVACION

Nën kujdesin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, paneli do të fokusohet në potencialin e diasporës shqiptare si një urë lidhëse për zhvillimin ekonomik, transferimin e njohurive dhe nxitjen e inovacionit në hapësirën shqiptare. Ai do të trajtojë mënyrat se si profesionistët dhe sipërmarrësit e diasporës mund të kontribuojnë përmes investimeve, mentorimit, bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe sjelljes së praktikave më të mira në tregun vendas. Paneli do të trajtojë gjithashtu mekanizmat lehtësues dhe bashkëpunimin institucional, duke propozuar zgjidhje konkrete për krijimin e një ekosistemi më të hapur dhe konkurrues. Përmes këtij diskutimi synohet të theksohet roli i diasporës jo vetëm si burim financiar, por si partner real dhe pjesëmarrës në transformimin ekonomik dhe teknologjik të vendit.

Moderator: **Znj. Aurora Sulçe** - Gazetare ekonomike, A2 CNN

Folës Kryesor: **Znj. Delina Ibrahimaj** - Ministër i Ekonomisë dhe Inovacionit

Panelistë:

- **Znj. Laura Plaku** - Drejtore Ekzekutive, Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve
- **Znj. Elira Kokona** - Drejtore Ekzekutive, Korporata Shqiptare e Investimeve
- **Z. Arben Shkodra** - Sekretar i Përgjithshëm, Këshilli Ekonomik Kombëtar
- **Z. Omer Nura** - Kryetar i Rrjetit Global të Bizneseve të Diasporës
- **Z. Arjan Ymeri** - Drejtor Ekzekutiv, Innovation4Albania
- **Z. Ardian Lekaj** - Kryetar i Dhomës së Bisnesit të Diasporës, anëtar i KKD
- **Z. Adrian Qytetza** - Ekspert i Sigurisë Kibernetike

Diskutim - P&P

PALLATI I KONGRESEVE - SALLA E VETINGUT

11⁰⁰ - 12³⁰

PANELI 3

DIASPORA DHE SISTEMI SHËNDETËSOR

Nën kujdesin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, paneli trajton rolin e rëndësishëm që profesionistët shqiptarë të shëndetësisë në diasporë mund të luajnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në vendet e origjinës. Diskutimi fokusohet në transferimin e njohurive, praktikave bashkëkohore dhe teknologjive mjekësore, si dhe në mundësitë për bashkëpunime konkrete mes institucioneve vendase dhe atyre ndërkombëtare ku veprojnë anëtarët e diasporës. Paneli gjithashtu analizon sfidat përfshirë nevojat për politika më mbështetëse, duke theksuar rëndësinë e krijimit të mekanizmave që lehtësojnë angazhimin e tyre të qëndrueshëm. Në këtë kuadër, synohet të evidentohet se diaspora nuk është vetëm një burim ekspertize, por një partner i vërtetë në reformimin dhe modernizimin e sistemit shëndetësor.

Moderator: **Znj. Mira Kazhani - Gazetare**

Folës Kryesor: **Prof. Evis Sala - Ministër i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale**

Panelistë:

- **Znj. Anxhela Paparizo** - Drejtore e Përgjithshme, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, QSUT
- **Z. Gentian Toshkezi** - Profesor i Asociuar, Departamenti i Neurokirurgjisë Penn State Univeresity
- **Znj. Arsela Prelaj** - MD, PhD, Mjeke onkologe dhe hulumtuese në fushën e Inteligjencës Artificiale në Onkologji
- **Znj. Egesta Lopçi** - Mjeke dhe Shkencëtare në fushën e Mjekësisë Bërthamore dhe Onkologjisë
- **Znj. Rudina Tahiri** - Shkencëtare analitike në terapinë qelizore dhe gjenetike, si dhe në inovacionin e ATMP-ve
- **Znj. Jona Doda** - Themeluese e startup-eve teknologjike dhe bashkëthemeluese e platformës së shëndetit mendor “BLISS”

Diskutim - P&P

PALLATI I KONGRESEVE - SALLA OVALE

11⁰⁰ - 12³⁰

PANELI 4

KËNDI I LIBRIT - “LIBRI SI URË IDENTITETI”

EKSPozITË KOLEKSIONESH NGA BIBLIOTEKA KOMBËTARE

Nën kujdesin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, me pjesëmarrjen e shkrimtarëve, studiuesve dhe botuesve aktualë më në zë, paneli vë në qendër rolin e librit si një mjet thelbësor për ruajtjen dhe transmetimin e identitetit kulturor dhe gjuhësor shqiptar, veçanërisht në diasporë. Ai trajton mënyrën se si letërsia, botimet dhe leximi në gjuhën shqipe shërbejnë si një urë lidhëse mes brezave dhe mes atdheut dhe komuniteteve shqiptare jashtë vendit. Paneli synon të nxisë diskutime mbi promovimin e autorëve shqiptarë, shpërndarjen e librave në diasporë dhe krijimin e hapësirave që mbështesin kulturën e leximit. Në këtë kuadër, theksohet se libri nuk është vetëm një burim dijeje, por edhe një mjet i fuqishëm për të ruajtur rrënjët, për të forcuar përkatësinë dhe për të mbajtur gjallë identitetin shqiptar në çdo cep të botës.

Moderator: **Znj. Majlinda Toçi** - Drejtore, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

Panelistë:

- **Z. Primo Shllaku** - Shkrimtar, përkthyes dhe studiues
- **Znj. Dhurata Shehri** - Studiuese e letërsisë dhe pedagoge
- **Z. Vehbi Miftari** - Studiues dhe diplomat
- **Znj. Rita Petro** - Shkrimtare dhe botuese
- **Z. Agron Alibali** - Studiues dhe Jurist
- **Znj. Flora Skëndo** - Sipërmarrëse dhe shkrimtare

Diskutim, P&P

12³⁰ - 13³⁰

DREKË

PALLATI I KONGRESEVE - HOLLI KRYESOR

13⁴⁵ - 15⁰⁰

PANELI 5

DIASPORA MBARËSHQIPTARE: A PO BËJMË ÇFARË DUHET BASHKARISHT?

Organizuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, paneli fokusohet në nevojën për një qasje të përbashkët dhe të mirë koordinuar ndërmjet Shqipërisë, Kosovës dhe përfaqësuesve shqiptarë në vendet e tjera të rajonit në raport me diasporën. Diskutimi do të theksojë rëndësinë e harmonizimit të politikave, shkëmbimit të praktikave më të mira dhe krijimit të mekanizmave të përbashkët institucionalë që fuqizojnë rolin e diasporës në zhvillimin ekonomik, kulturor dhe politik. Paneli synon të analizojë sfidat që lidhen me fragmentimin institucional dhe mungesën e koordinimit, duke nxitur reflektim mbi mënyrat konkrete se si aktorët shqiptarë mund të veprojnë më të bashkuar për të maksimalizuar potencialin e diasporës. Në këtë kuadër, synohet të theksohet se vetëm përmes bashkëpunimit të qëndrueshëm dhe një vizioni të përbashkët mund të arrihet një angazhim më efektiv dhe gjithëpërfshirës i diasporës mbarë shqiptare.

Moderator: **Znj. Rudina Xhunga - Gazetare**

Panelistë:

- **SH.T.Z. Ferit Hoxha** - Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme
- **SH.T.Z. Glauk Konjufca** - Zëvendëskryeministër i Parë dhe Ministër i Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Republikës së Kosovës
- **Z. Ali Ahmeti** - Kryetar i Bashkimit Demokratik për Integrim/BDI-së, RMV
- **Z. Dritan Abazovic** - Ish Kryeministër dhe Deputet, Mali i Zi
- **Z. Arbër Gashi** - Deputet në Parlamentin suedez
- **Z. Lazim Destani** - Kryetar i Këshillit Koordinues të Diasporës

Diskutim - P&P

PALLATI I KONGRESEVE - HOLLI KRYESOR

15¹⁵ - 16³⁰

PANELI 6

STANDARDIZIMI DHE CERTIFIKIMI I GJUHËS SHQIPE NË DIASPORË

Nën kujdesin e Ministrisë së Arsimit, paneli synon të trajtojë në mënyrë të integruar sfidat dhe perspektivat e mësimdhënies së gjuhës shqipe në diasporë në epokën digjitale. Diskutimi do të fokusohet në domosdoshmërinë e standardizimit të kurrikulave, zhvillimin e platformave digjitale bashkëkohore, si dhe ngritjen e një sistemi të njohur ndërkombëtarisht për certifikimin e gjuhës shqipe. Në këtë kuadër, paneli do të prezantojë edhe vizionin institucional për krijimin e Agjencisë Kombëtare për Gjuhën Shqipe në Diasporë, e cila parashikohet të luajë një rol koordinues në përcaktimin e standardeve, zhvillimin e proceseve të certifikimit dhe ndërtimin e një rrjeti global të mësimdhënies së shqipes. Ky institucion synon të vendosë një mekanizëm të qëndrueshëm kombëtar për koordinimin, standardizimin dhe certifikimin e mësimin të gjuhës shqipe në diasporë, në përputhje me Kornizën e Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët (CEFR).

Moderator: **Znj. Mimoza Hysa - Drejtoreshë e Qendrës së Botimeve për Diasporën**

Folës Kryesor: **Znj. Mirela Kumbaro Furrxhi - Ministër i Arsimit**

Panelistë:

- **Znj. Drita Gjongecaj** - Mësuese e gjuhës shqipe në Nju Jork, SHBA Anëtare e Këshillit Koordinues të Diasporës
- **Z. Ragip Zekolli** - Bashkë autor i kurrikulave në gjuhën shqipe, Belgjikë
- **Znj. Linda Mëniku** - Profesore në FHF dhe Gjuhëtare
- **Z. Stavri Dajo** - Pedagog, Instituti i Studimeve Ballkanike, Selanik
- **Z. Mevlan Ademi** - Lëvizja Studentore në MV për mbrojtjen e Gjuhës Shqipe në Universitete

Diskutim - P&P

PALLATI I KONGRESEVE - SALLA OVALE

14³⁰ - 16⁰⁰

PANELI 7

DIASPORA DHE KËRKIMI SHKENCOR

Nën kujdesin e Ministrisë së Arsimit, paneli trajton rolin e diasporës akademike shqiptare në avancimin e kërkimit shkencor dhe zhvillimit të arsimit të lartë në hapësirën shqiptare. Ai fokusohet në mundësitë që ofrojnë programet për të krijuar ura bashkëpunimi mes studiuesve në diasporë dhe institucioneve vendase, duke nxitur projekte të përbashkëta kërkimore, shkëmbim njohurish dhe rritje të kapaciteteve akademike. Paneli gjithashtu analizon sfidat që lidhen me integrimin e këtij potenciali, si infrastruktura kërkimore bashkëkohore apo koordinimit institucional, dhe do të tentojë të propozojë mënyra për t'i adresuar ato në mënyrë efektive. Diskutimi synon të theksojë se angazhimi i diasporës shkencore është një aset i çmuar për modernizimin e kërkimit dhe për rritjen e cilësisë në arsimin dhe inovacionin në vend.

Moderator: **Znj. Armela Baka - Zëvendësministre e Arsimit**

Panelistë:

- **Znj. Eglantina Kalluci** - Dekane e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, UT
- **Z. Arben Merkoçi** - Profesor i Nanoteknologjisë, Spanjë
- **Prof. Dr. Jusuf Zejneli** - Rektori Universitetit të Tetovës
- **Znj. Daniel Pirushi** - Drejtoreshë në AKKSHI
- **Znj. Enkelejda Kapia** - Profesore Katedra e Gjuhës Shqipe, Mynih
- **Z. Dhori Qirjazi** - Profesor i Gjuhësisë Historike në Universitetin Aristoteli të Selanikut, Greqi
- **Z. Evarist Stoja** - Profesor në Financë, Angli

Diskutim - P&P

PALLATI I KONGRESEVE - SALLA E ALBANOLOGJISË

14³⁰ - 16⁰⁰

PANELI 8

ZHVILLIMI LOKAL DHE TERRITORIAL - A KA ROL PËR DIASPORËN?

Nën kujdesin e Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, paneli trajton rëndësinë e lidhjes së ngushtë, ekonomike dhe sociale, që anëtarët e diasporës ruajnë me vendin apo zonën e tyre të origjinës. Diskutimi përqendrohet në mënyrat konkrete se si kjo lidhje mund të shndërrohet në motor zhvillimi për komunitetet lokale dhe rurale, përmes investimeve të vogla e të mesme, rikthimit të njohurive dhe përvojave, si dhe mbështetjes së iniciativave komunitare. Paneli gjithashtu analizon potencialin e diasporës për të nxitur turizmin lokal, ruajtjen e trashëgimisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm, duke theksuar se angazhimi i tyre është më efektiv kur lidhet drejtpërdrejt me rrënjët dhe identitetin e tyre lokal. Në këtë kuadër, synohet të evidentohet se diaspora nuk është vetëm një burim i jashtëm, por një aktor i brendshëm me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e zonave nga të cilat vjen.

Moderator: **Z. Kreshnik Kuçaj** - Gazetar, Drejtor Informacioni në SCAN TV

Folës Kryesor: **Z. Ervin Demo** - Ministër Shteti për Pushtetin Vendor

Panelistë:

- **Z. Elbert Krasniqi** - Ministri për Pushtetin Lokal i Republikës së Kosovës
- **Z. Fatmir Limani** - Ministër për Politikat Sociale, Demografisë dhe të Rinjve, RMV
- **Z. Emiriana Sako** - Kryetare e Bashkisë Durrës
- **Z. Qemajl Aliu** - Kryetar i Komunës Shtimje, Kosovë
- **Znj. Ardita Sinani** - Kryetare e Komunës së Preshevës
- **Znj. Luiza Duraki** - Zëvendëskryetare e Bashkisë, Anderlecht, Belgjikë
- **Znj. Adelajda Roka** - Drejtore Ekzekutive, Agjencia e Zhvillimit të Territorit
- **Znj. Vera Mjeku** - Menaxhere Programesh dhe Analiste Politikash për Këshillin Bashkiak në Qytetin e Nju Jorkut

Diskutim - P&P

PALLATI I KONGRESEVE - SALLA E VETINGUT

14³⁰ - 16⁰⁰

PANELI 9

RRËNJËT QË RIKTHEJNË VLERË

NGA PËRVOJA NDËRKOMBËTARE NË ADMINISTRATË PUBLIKE

I organizuar nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, aktiviteti vendos në qendër ekspertizën e diasporës që rikthehet dhe kontribuon në administratën publike dhe institucionet shtetërore. Paneli synon të paraqesë histori konkrete sukcesi të profesionistëve të rikthyer, duke i promovuar ata si modele frymëzuese dhe si dëshmi të transferimit të njohurive dhe përvojës ndërkombëtare në Shqipëri. Njëkohësisht, diskutimi do të fokusohet në nxitjen e angazhimit më të gjerë të ekspertëve të diasporës në mbështetje të procesit të integritimit evropian në forcimin e kapaciteteve të administratës publike. Sesioni do të prezantojë edhe arkitekturën tashmë të ngritur për angazhimin e profesionistëve të diasporës, duke mundësuar kontributin e tyre si fizikisht ashtu edhe në distancë, në bashkëpunim me ekipet vendase. Ky dimension merr rëndësi të veçantë në kuadër të momentit historik të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, duke theksuar nevojën për mekanizma të qëndrueshëm bashkëpunimi ndërmjet diasporës dhe institucioneve shqiptare.

Video “Call for Action” për angazhimin e diasporës

Moderatore: **Znj. Fjoralba Caka** - Pedagogje pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universitetit të Tiranës

Folës Kryesor: **Znj. Adea Pirdeni** - Ministër Shteti për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin

Panelistë:

- **Z. Marash Dukaj** - Ministër i Administratës Publike i Malit të Zi
- **Znj. Vilma Premti** - Zëvendësministre për Evropën dhe Punët e Jashtme
- **Z. Andi Memeti** - Zëvendësministër i Financës
- **Znj. Enida Rrapaj** - Juriste, Kryetare e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë BE-Belgjikë-Shqipëri, Bruksel
- **Z. Erion Begaj** - Këshilltar i Jashtëm për Çështjet e diasporës pranë Parlamentit, Jurist në Itali
- **Z. Kristi Kadzadej** - Këshilltar i Jashtëm për sektorin elektroenergjitik pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Konsulent në Mbretërinë e Bashkuar

Diskutim - P&P

PIRAMIDA E TIRANËS | INNOVATION HUB

16²⁰ - 16³⁰

REGJISTRIMI

16³⁰ - 17³⁰

HAPJA E SESIONIT

TRANSFORMIMI I SHËRBIMEVE NDAJ KLIENTIT: NGA OUTSOURCING DREJT ZGJIDHJEVE TË MBËSHTETURA NGA AI

Paneli do të shqyrtojë evolucionin e industrisë së shërbimeve ndaj klientit, nga modeli tradicional i outsourcing drejt zgjidhjeve inteligjente të mbështetura nga inteligjenca artificiale. Diskutimi do të fokusohet në rolin e startup-eve dhe kompanive inovative në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve përmes automatizimit, përdorimit të të dhënave dhe krijimit të përvojave më të personalizuar për klientin. Në këtë kuadër, paneli do të trajtojë potencialin e Shqipërisë për t’u pozicionuar më fuqishëm në tregun global, duke vënë në pah edhe kontributin e përfaqësuesve të sipërmarrjes dhe teknologjisë nga diaspora shqiptare në forcimin e konkurrueshmërisë së vendit në ekonominë digjitale.

Moderatore: **Z. Uranik Begu - Drejtor Menaxherial, Rajoni i Evropës Qendrore dhe Lindore, Plug and Play**

Panelistë:

- **Z. Endri Burrja** - Themelues, Medwallet
- **Z. Flamur Jashari** - Themelues dhe Drejtues Ekzekutiv, Yuuniq Health
- **Znj. Eva Gjoni** - Bashkëthemeluese dhe Drejtuese Ekzekutive, Senseven Health
- **Znj. Eniada Halebi** - Themeluese dhe Drejtuese Ekzekutive, ATELIA Digital
- **Znj. Elisa Ago** - Bashkëthemeluese dhe Menaxhere Produkti, Tribu World

Diskutim - P&P

PALLATI I KONGRESEVE - SALLA E KONCERTEVE

18³⁰ - 21⁰⁰

MBRËMJA GALA E SAMITIT IV TË DIASPORËS SHQIPTARE

Me pjesëmarrjen e të gjithë personaliteteve në Shqipëri dhe Diasporë

E MËRKURË - 15 PRILL

PALLATI I KONGRESEVE

08³⁰ - 09⁰⁰ MBËRRITJA E TË FTUARVE

PALLATI I KONGRESEVE - HOLLI KRYESOR

09⁰⁰ - 09³⁰ MËNGJESI I VËLLAZËRIMIT

Komunitet fetare në një mëngjes bekimesh për Shqipërinë

Moderatore: Znj. Monika Stafa, Gazetare

Folës Kryesor: Imam Dr. Rifat Halili - Qendra Islame Shqiptare, New York dhe New Jersey

Lutje dhe Bekime:

- *Imam Dr. Rifat Halili - Qendra Islame Shqiptare, New York dhe New Jersey*
- *Haxhi Dede Baba Edmond Brahimaj - Kryegjyshi Botëror Bektashian*
- *Rev. Nikodhim Preston - Peshkop i Krye Dioqezës së Shqipërisë në Boston*
- *Don Kastriot Idrizi - Bashkësia Katolike Shqiptare në Bruksel, Belgjike*
- *Erjon Sylari - Vëllazëria Ungjillore*

PALLATI I KONGRESEVE - HOLLI KRYESOR

09⁴⁵ - 10³⁰

PANELI 10 TRASHËGIMIA E SË SHENJTËS

*Ky aktivitet i veçantë si dhe tryeza që e pason, përfaqësojnë një moment reflektimi dhe bashkimi shpirtëror, ku përfaqësues të komuniteteve fetare nga të gjitha besimet mblidhen për të ndarë mesazhe paqeje, harmonie dhe shprese. Ky aktivitet thekson traditën e bashkëjetesës dhe tolerancës fetare si një nga vlerat më të çmuara të shoqërisë shqiptare, duke sjellë në vëmendje rëndësinë e dialogut ndërfeetar dhe respektit të ndërsjellë. Përmes një atmosfere simbolike dhe përfshirëse, “Mëngjesi i Bekimeve” synon të forcojë unitetin dhe të frymëzojë angazhimin e përbashkët për të mirën e vendit, duke e konsideruar trashëgiminë shpirtërore si një themel të rëndësishëm për të ardhmen. **Pjesëmarrja në këtë aktivitet me ftesë të veçantë.***

Panelistë

- **Imam Dr. Rifat Halili** - Qendra Islame Shqiptare, New York dhe New Jersey
- **Rev. Nikodhim Preston** - Peshkop i Krye Dioqezës së Shqipërisë në Boston
- **Besnik Sinani** - Doktor Filozofie në Histori dhe Studime Islamike
- **Prof. Zekirija Sejdini** - Profesor i teologjisë islame, Universiteti i Vjenës
- **Hafiz Mehas Alija** - Kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër
- **Imam Laurent Ibra** - Sekretar i Përgjithshëm i Unionit të Qendrave Islame Shqiptare në Gjermani
- **Don Kastriot Idrizi** - Bashkësia Katolike Shqiptare në Bruksel, Belgjike

PALLATI I KONGRESEVE - SALLA VETINGUT

10⁰⁰ - 11³⁰

PANELI 11

DIASPORA SHQIPTARE SI PARTNER MBËSHTETËS PËR INTEGRIMIN EVROPIAN DHE ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM

Nën kujdesin e Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociatorit, paneli synon të trajtojë në mënyrë të strukturuar rolin e diasporës shqiptare si një aktor strategjik në përshpejtimin e integritimit evropian dhe në mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. Diskutimi pritet të fokusohet në identifikimin e prioriteteve kryesore ku kontributi i diasporës mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë, si dhe në mënyrat konkrete të integritimit të këtij potenciali në politikat publike dhe në proceset e përafrimit me Bashkimin Evropian. Qëllimi i panelit është të ofrojë një drejtim të qartë strategjik, duke nxitur një qasje më të koordinuar ndër-institucionale dhe duke orientuar angazhimin e diasporës drejt mekanizmave të qëndrueshëm, të matshëm dhe të zbatueshëm.

Moderator: **Z. Eriseld Zeneli**, Zyrtar, *Burimet Njerëzore në Parlamentin Evropian në Luksemburg*

Panelistë:

- **Znj. Majlinda Dhuka** - Ministër Shteti dhe Kryenegociatore
- **Z. Sofjan Jaupaj** - Ministër i Mjedisit
- **Znj. Natasha Ahmeti** - Zëvendësguvernatore, Banka e Shqipërisë
- **Znj. Elona Ajazi** - Drejtor i Departamentit të Politikave dhe Integritimit Evropian në Kryeministri
- **Z. Ilir Gëdeshi** - Drejtor i Qendrës për Studime Ekonomike dhe Sociale
- **Znj. Amy Kokalari** - Kërkuese dhe analiste politikash

Diskutim P&P

PALLATI I KONGRESEVE - SALLA E ALBANOLOGJISË

10⁰⁰ - 11³⁰

PANELI 12

BOTA ARBËRESHE

Paneli i kushtohet trashëgimisë së pasur kulturore, historike dhe gjuhësore të komuniteteve arbëreshe, si një pjesë e rëndësishme e identitetit mbarëshqiptar. Ai trajton ruajtjen ndër shekuj të traditave, gjuhës dhe zakoneve shqiptare në diasporën historike, si dhe sfidat që lidhen me përcjelljen e këtij identiteti tek brezat e rinj. Paneli gjithashtu nxjerr në pah rolin e arbëreshëve si urë lidhëse mes kulturës shqiptare dhe asaj evropiane, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit kulturor, akademik dhe institucional për të mbështetur dhe promovuar këtë trashëgimi unike. Në thelb, diskutimi synon të vlerësojë kontributin e botës arbëreshe në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe në pasurimin e mozaikut kulturor shqiptar.

Moderator: **Znj. Diana Kastrati** - Drejtore Ekzekutive e QSPA-së

Panelistë:

- **Znj Fernanda Pugliese** - Sporteli gjuhësor, Molise
- **Znj Sabrina Rasom** - Funksiore e Istitut Cultural Ladin e Biblioteca, Alto Adige
- **Z. Lorenzo Lonoce** - Këshilltar komunal për mbrojtjen e gjuhës dhe kulturës arbëreshe në San Marzano di San Giuseppe - Puglia
- **Z. Leandro Ventura** - Drejtor i Institutit të Trashëgimisë Jomateriale në Ministrinë Italiane të Kulturës
- **Z. Giulio Castriota Scanderbeg** - Pasardhës i Familjes së Kastriotëve, Gjykatës, Itali
- **Znj. Erilda Selaj** - Drejtoresha e Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale
- **Znj. Geri Ballo** - Presidente e “Made in Arberia”
- **Z. Rosario Petta** - Kryetar Bashkie në “Piana degli Albanesi”, Komuna Arbëreshe në Itali

Ekzekutimi i ritualit të veshjes së nuses arbëreshe nga:

- **Elisabeth D’Elia**
- **Venere Ricioppo**
- **Alessandra Roberto**
- **Melicchio Caterina**

PALLATI I KONGRESEVE - SALLA OVALE

11⁰⁰ - 12⁰⁰

PANELI 13

MIGRACIONI DHE POLITIKAT E RIATDHËSIMI

MIGRACIONI, SHTETËSIA DHE DIASPORA DREJT NJË QASJEJE TË INTEGRUAR PËR ANGAZHIM DHE SHËRBIME

Nën kujdesin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, paneli fokusohet në menaxhimin e migracionit dhe angazhimin e diasporës shqiptare përmes një qasjeje të integruar, duke theksuar përmirësimin e shërbimeve, digjitalizimin, regjistrimin e të dhënave dhe forcimin e koordinimit institucional. Në përputhje me strategjitë kombëtare deri në vitin 2030, diskutimi synon të rrisë përfshirjen e diasporës në zhvillimin kombëtar dhe të forcojë lidhjet e saj me vendin. Njëkohësisht, paneli do t'i ofrojë audiencës, veçanërisht përfaqësuesve të diasporës, një kuptim më të qartë mbi mundësitë konkrete të angazhimit me institucionet shqiptare dhe përfitimet nga shërbimet e përmirësuara dhe të digjitalizuara, duke krijuar një hapësirë dialogu dhe bashkëpunimi që nxit besimin, përfshirjen aktive dhe ndjenjën e përkatësisë, si dhe inkurajon kontributin e drejtpërdrejtë të diasporës në zhvillimin ekonomik, social dhe institucional të vendit.

Moderator: **Znj. Alba Xhani - Gazetare**

Folës Kryesorë: **Z. Besfort Lamallari - Ministër i Punëve të Brendshme**

Panelistë:

- **Z. Skënder Hita** - Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit (Drejtues Madhor)
- **Znj. Silda Anagnosti Çepe** - Administratore pranë IdentiTek
- **Znj. Enkeleda Shpuza** - Drejtoreshë, Drejtorja e Standardizimit të Shërbimeve të Gjendjes Civile
- **Znj. Alma Jani** - Shefe e Zyrës së IOM në Shqipëri (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin)

Diskutim, P&P

PALLATI I KONGRESEVE - SALLA E VETINGUT

11⁴⁵ - 13⁰⁰

PANELI 14

IDENTITETI KOMBËTAR DHE QENDRAT KULTURORE INSTITUCIONALIZIMI I DIPLOMACISË KULTURORE: CULTURALB DHE RRJETI I RI I QENDRAVE KULTURORE

Paneli fokusohet në rolin kyç që qendrat kulturore luajnë në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kombëtar në diasporë. Diskutimi trajton mënyrat se si vizioni për krijimin e hapësirave kulturore shqiptare jashtë vendit mund të konkretizohet përmes modeleve të suksesshme ndërkombëtare, bashkëpunimit institucional dhe përfshirjes së komuniteteve lokale. Paneli analizon sfidat praktike në ngritjen dhe funksionimin e këtyre qendrave, si financimi, menaxhimi dhe programimi kulturor, duke sjellë shembuj dhe përvoja që mund të përshtaten në kontekstin shqiptar. Në thelb, qendrat kulturore janë më shumë se hapësira fizike; ato janë ura që lidhin brezat me rrënjët e tyre dhe promovojnë kulturën shqiptare në një dimension global.

Moderator: **Z. Eljan Tanini** - Gazetar, Drejtor i Arkivit Qëndror Shtetëror të Filmit

Folës Kryesor: **Z. Blendi Gonxhja** - Ministër i Turizmit, Kulturës dhe Sportit,

Panelistë:

- **Znj. Saranda Bogujevci** - Ministre e Kulturës dhe Turizmit, Republika e Kosovës
- **Znj. Lira Pipa** - Zëvendësministre e Turizmit, Kulturës dhe Sportit
- **Znj. Arta Marku** - Drejtuese e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit
- **Znj. Anila Smørgrav** - Nënkryetare e Këshillit Koordinues të Diasporës, Bashkëthemeluese dhe anëtare e Bordit Drejtuese të Qendrës Kulturore Shqiptare “28-11”
- **Z. Lutfi Vata** - Shoqata “Ardhmeria” në Londër

Diskutim P&P

PALLATI I KONGRESEVE - SALLA E VETINGUT

14¹⁵ - 15³⁰

PANELI 15

RRUGA PËRPARA — NGA KOMUNIKIMI TE BASHKËVEPRIMI

Fokus: Diaspora si partner funksional dhe ndërveprimi me institucionet shqiptare

(Prezantimi i linjave kryesore Strategjia Kombëtare e Diasporës 2026-2030)

Rruga Përpara — nga Komunikimi te Bashkëveprimi” synon të nxisë dialogun me diasporën shqiptare përmes një shkëmbimi idesh dhe për të kaluar më pas në një partneritet konkret dhe të qëndrueshëm. Paneli do të paraqesë në vija të përgjithshme strategjinë për diasporën në Shqipëri, që është duke u hartuar, duke hapur njëkohësisht një diskutim të drejtpërdrejtë dhe gjithëpërfshirës me anëtarët e saj. Në qendër të vëmendjes qëndron roli i diasporës si një partner funksional në zhvillimin ekonomik, kulturor dhe institucional të vendit, si dhe nevoja për ndërtimin e mekanizmave efektivë të ndërveprimit me institucionet shqiptare. Përmes këtij paneli synohet të identifikohen rrugë konkrete bashkëpunimi, duke forcuar besimin, koordinimin dhe përfshirjen aktive të diasporës në proceset vendimmarrëse dhe zhvillimore.

NËNSHKRIM MARRËVESHJEJE

(AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS ME AGJENCINË KOMBËTARE TË RINISË)

Moderator: Z. Thimi Samarxhiu - Gazetar

Folës Kryesor: Z. Ferit Hoxha - Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme

Panelistë:

- **Znj. Klodiana Spahiu** - Zëvendëskryetare e Parlamentit shqiptar
- **Znj. Ermonela Xhafa** - Drejtore Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës
- **Znj. Edit Shkreli** - Gjyqtarja e pare shqiptare në Gjykatën e Nju Jorkut
- **Znj. Valmira Guzi** - Konsulente e IOM për Strategjinë
- **Znj. Erinda Ndroqi** - IANS, Eksperte, vlerësuese e Strategjisë aktuale, GIZ
- **Znj. Joniada Barjaba** - Drejtore, Drejtorja e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës

Diskutim P&P

PALLATI I KONGRESEVE - SALLA E ALBANOLOGJISË

12⁰⁰ - 13⁰⁰

PANELI 16

ROLI I DIASPORËS NË PROMOVIMIN E TURIZMIT

Nën kujdesin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, ky panel do të trajtojë rolin kyç të diasporës shqiptare si një urë lidhëse ndërmjet Shqipërisë dhe tregjeve ndërkombëtare në zhvillimin e turizmit. Përmes përvojave dhe praktikave të profesionistëve që jetojnë dhe veprojnë jashtë vendit, do të eksplorohehen mënyrat se si njohuritë, rrjetet dhe modelet e suksesshme mund të përshtaten për të rritur cilësinë dhe konkurrueshmërinë e ofertës turistike shqiptare. Paneli do të sjellë në fokus perspektivat e aktorëve të rëndësishëm të sektorit, përfshirë tour operatorë dhe profesionistë të fushës së promovimit, të cilët do të ndajnë eksperiencat e tyre në ndërtimin dhe pozicionimin e brandit shqiptar në tregjet ndërkombëtare. Diskutimi do të theksojë rëndësinë e strategjive të marketingut, bashkëpunimit ndërsektorial dhe krijimit të një imazhi të qëndrueshëm dhe tërheqës për Shqipërinë si destinacion turistik, duke synuar rritjen e vizibilitetit dhe konkurrueshmërisë së saj globale.

Moderator: **Znj. Marinela Prifti, Zëvendësministër, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit**

Panelistë:

- **Znj. Zana Cela** - Drejtor i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Turizmit
- **Z. Rrahman Kasa** - Kryetar i Shoqatës së Tour Operatorëve
- **Znj. Blerina Ago** - Eksperte Turizmi
- **Z. Armando Muca** - Albanian Night
- **Z. Fundim Gjepali** - Shef kuzhine dhe sipërmarrës, themelues i një rrjeti restorantesh në Tiranë dhe Romë
- **Znj. Aina Hoti** - Themeluese e vizonit “Destination Albania”, Zvicër
- **Z. Luan Kukaj** - Sipërmarrës dhe biznesmen, Themelues i “Kookai Group”, Greqi

Diskutim P&P

13⁰⁰ - 14⁰⁰

DREKË

PALLATI I KONGRESEVE - SALLA E ALBANOLOGJISË

14¹⁵ - 16⁰⁰

PANELI 17

USHQIMI NGA FUSHA TEK TAVOLINA

Nën kujdesin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ky panel i dedikohet rolit dhe kontributit të diasporës shqiptare në forcimin e hallkave që lidhin prodhimin bujqësor me tavolinën, nga fusha dhe sera, tek agropërpunimi, agrobiznesi, bujtinat dhe restorantet ndërkombëtare. Përmes përvojave konkrete të sipërmarrësve dhe profesionistëve që operojnë brenda dhe jashtë vendit, paneli do të sjellë në vëmendje se si kapitali njerëzor, njohuria teknike dhe ekspozimi ndaj standardeve ndërkombëtare mund të shndërrohen në motorë të modernizimit të bujqësisë shqiptare. Diskutimi do të fokusohet në rolin e diasporës në nxitjen e teknologjive të reja në prodhim, në përmirësimin e cilësisë dhe të standardeve, si edhe në krijimin e një zinxhiri më të fortë vlerë midis fermerit, përpunuesit, sipërmarrjes turistike dhe konsumatorit. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përdorimit të produkteve kombëtare si tregues i identitetit tonë, produkte që lindin në fushat shqiptare dhe marrin kuptim të shtuar kur shërbehen në agrobiznese, bujtina dhe restorante të nivelit të lartë, brenda dhe jashtë Shqipërisë. Paneli do të trajtojë gjithashtu mënyrat se si ushqimi shqiptar mund të pozicionohet jo vetëm si produkt ekonomik, por edhe si shprehje e kulturës, territorit dhe dinjitetit tonë kombëtar. Përmes shembujve konkretë dhe historive të suksesit, ai synon të ofrojë ide dhe rekomandime praktike për një model zhvillimi ku bujqësia, gastronomia dhe diaspora veprojnë si një ekosistem i vetëm vlerash.

Moderator: **Z. Fatmir Guri** - Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Folës Kryesor: **Z. Andis Salla** - Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Panelistë:

- **Z. Emiljano Biraku** - Sipërmarrës në sektorin e gastronomisë, drejtues i një rrjeti restorantesh në Itali
- **Znj. Irda Vogli** - Sipërmarrëse në fushën e gastronomisë, themeluese e një restoranti në Kopenhagën
- **Z. Franc Bakalli** - Sipërmarrës në fushën e agropërpunimit
- **Znj. Eli Bardhi** - Sipërmarrëse në sektorin e serave
- **Z. Kujtim Skenderi** - Sipërmarrës në fushën e agropërpunimit
- **Znj. Johana Bano** - Sipërmarrëse në fushën e agroturizmit

Diskutim P&P

PALLATI I KONGRESEVE - SALLA OVALE

14¹⁵ - 15³⁰

PANELI 18

DIASPORA SHQIPTARE DHE FUQIA E SPORTIT

Nën kujdesin e Ministrisë së Turizmit, së Kulturës dhe Sportit, paneli do të trajtojë rolin gjithnjë në rritje të sportit si një instrument i fuqishëm i diplomacisë publike dhe i promovimit të imazhit të Shqipërisë në Evropë dhe më gjerë. Ai fokusohet në kontributin e sportistëve shqiptarë në diasporë, të cilët përmes arritjeve të tyre ndërkombëtare shërbejnë si përfaqësues natyralë të vendit, duke forcuar identitetin kombëtar dhe duke rritur vizibilitetin e Shqipërisë në arenën globale. Paneli gjithashtu analizon mënyrat se si ky potencial mund të strukturohet dhe mbështetet institucionalisht, përmes bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, federatave sportive dhe vetë diasporës, për të kthyer suksesin individual në një aset strategjik të “soft power”-it shqiptar. Në këtë kuadër, synohet të theksohet se sporti nuk është vetëm garë dhe performancë, por edhe një mjet i rëndësishëm për ndërtimin e urave kulturore, forcimin e diplomacisë dhe afirmimin e Shqipërisë në Evropë.

Moderator: **Z. Kolë Gjeloshaj** - Drejtues i Organizatave Sportive Ndërkombëtare, Belgjikë

Panelistë:

- **Z. Blerim Gashani** - Ministër i Sportit dhe Rinisë, Republika e Kosovës
- **Z. Endrit Hoxha** - Zëvendësministër i Turizmit, Kulturës dhe Sportit
- **Z. Armando Duka** - President i Federatës Shqiptare të Futbollit
- **Z. Granit Muçaj** - President i Federatës Kombëtare të Shoqatave Shqiptare ne Itali “FNAI”
- **Z. Altin Lala** - Ish-kapiten i Kombëtares Shqiptare
- **Z. Lorik Cana** - Ish-futbollist dhe kapiten i Kombëtares Shqiptare

Diskutim P&P

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT KOMBËTAR

17⁰⁰ - 18¹⁵

PANELI 19

ZËRAT E DIASPORËS - KRIJIMTARIA, IDENTITETI DHE FRYMA SHQIPTARE NË ARTIN BASHKËKOHOR

Nën kujdesin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, paneli fokusohet në rolin e artistëve shqiptarë në diasporë si bartës dhe interpretues të identitetit kulturor në një kontekst global. Ai trajton mënyrën se si krijimtaria artistike shërben si një urë lidhëse mes rrënjëve dhe realiteteve të reja, duke reflektuar përvojat, sfidat dhe pasuritë e një identiteti në lëvizje. Paneli nxjerr në pah ndikimin e këtyre zërave në skenën ndërkombëtare të artit, si dhe potencialin e tyre për të promovuar kulturën shqiptare përmes formave bashkëkohore të shprehjes. Në këtë kuadër, synohet të theksohet se arti i diasporës nuk është vetëm një formë individuale krijimi, por një hapësirë kolektive që ruan, transformon dhe afirmon frymën shqiptare në botë.

Panelistë:

- **Z. Aulon Naçi** - Drejtor i Përgjithshëm i Tetarit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor
- **Z. Gëzim Myshketa** - Bariton
- **Z. Salvadore Frega** - Kompozitor
- **Znj. Anbeta Toromani** - Balerinë
- **Znj. Marigona Qerkezi** - Soprano

Pjesë e veçantë: Përshëndetje artistike nga pjesëmarrësit

AKTIVITETE NË AMBIENTET E PALLATIT TË KONGRESEVE 14 - 15 PRILL 2026

- ✦ B2B - DIASPORA BUSINESS HUB
- ✦ RRJETËZIM DHE PREZANTIME
- ✦ HAPËSIRA ME PRODUKTE “MADE IN ALBANIA”
- ✦ PREZANTIME TË PROJEKTEVE PËR DIASPORËN
- ✦ PROGRAM EDUKATIV PËR FËMIJË
- ✦ DOKUMENTARË TË NDRYSHËM
- ✦ EKSPozITË ME MATERIALE TË PËRZGJEDHURA NGA ARKIVI I MINISTRISË PËR EVROPEN DHE PUNËT E JASHTME
- ✦ EKSPozITA “PARAJA RRËFEN: 100 VJET JETË DHE NGJARJE”, BANKA E SHQIPËRISË
- ✦ EKSPozITA “ATDHEU NË FAQE - KUJTËSA E MËRGATËS SHQIPTARE”, BIBLIOTEKA KOMBËTARE E SHQIPËRISË
- ✦ EKSPozITA ME MATERIALE ARKIVORE MBI ARBËRESHËT NGA ARKIVI I SHTETIT
- ✦ EKSPozITA E BOTIMEVE TË QSPA-SË
- ✦ HAPËSIRA INFORMUESE PËR PROGRAMET E DIASPORËS
- ✦ KËNDI I TRASHËGIMISË/STENDA E TRADITËS POPULLORE
- ✦ KËNDI I MUZEUT BESA
- ✦ MEDIA/VIDEO CORNER